



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i dosjes: KSCPR-2021
Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Administratore: Fidelma Donlon
Data: 11 janar 2021
Gjuha: Anglishte
Titulli i dosjes: Dosje e Administrimit Gjyqësor për Vitin 2021

PUBLIKE

**Vendim për Krijimin dhe Përbërjen e Paneleve për Apelet e
Punonjësve**

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të rregullës 83(b) të Rregullores për Punonjësit e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("Rregullorja për Punonjësit"),¹ rregullës 6(1)(i)-(ii) të Rregullores së Procedurës për Apelet e Punonjësve ("Procedura e Apeleve të Punonjësve")² dhe rregullës 4(2) dhe (3) e për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"),³ me anë të këtij vendimi krijon dy Panele për Apelet e Punonjësve, të përbërë prej gjykatësve nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë, për gjykimin e apeleve të paraqitura sipas rregullës 83(a) të Rregullores për Punonjësit dhe të çështjeve të lidhura me to.

Gjatë vendosjes për përbërjen e Paneleve të Apeleve të Punonjësve, dhe në pajtim me rregullën 6(1) dhe (2) të Procedurës për Apelet e Punonjësve, Kryetarja është bazuar në kriteret objektive të përcaktuara në rregullën 4(2) dhe (3) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve si përvoja, kompetenca, përparësia në bazë të datës së emërimit ose të moshës, përfaqësimi gjinor e gjeografik dhe disponueshmëria, si edhe veprimtaria e mëhershme e një gjykatësi që me gjasë vë në dyshim paanshmërinë e tij ose të saj apo ndikon në ndershmërinë e procesit.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARJA:

Cakton me efekt të menjëhershëm, për një vit:

1. a) në nënlistën e gjykatësve për apelet e punonjësve, të listës së parë të gjykatësve për apelet e punonjësve, gjykatësin Tomas Laker; dhe

¹ KSC-RI-01-v.1.3, 4 qershor 2020.

² KSC-RI-02-v2.0, 31 mars 2020.

³ KSC-BD-02, 14 mars 2017.

b) në nënlistën e gjykatësve të lartë për apelet e punonjësve, të listës së parë të gjykatësve për apelet e punonjësve, gjykatësen Kristinë van den Vajngart.

2. Në listën e dytë të gjykatësve për apelet e punonjësve:

- a) gjykatësin Mihael Bolander
- b) gjykatësin Daniel Fransen
- c) gjykatësen Nina Jorgensen

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 11 janar 2021
Në Hagë, Holandë.